



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	01-4928/14
Nr. fletë	02
Biro/stranica	
Nr. pages	
D.M. SHTINE	
Nr. Prot.	
Br. Prot.	
Prot. No.	
Data	
Datum	
Date	19-12-2014



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 18.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK- 03-3757/14, për, ish zyrtarin e lartë z. Kadrush Shala, zyrtar i lartë i prokurimit ne KRU-“RADONIQI sh.a, për shkak se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3757/14,qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Kadrush Shala, zyrtar i lartë i Prokurimit ne KRU “Radoniqi” sh.a. Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Kadrush Shala, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë i prokurimit ne KRU “Radoniqi sh.a”, është identifikuar se është duke ushtruar aktivitet ne veprimtari private si pronar dhe person i autorizuar, ne një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situate paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korruptionit me datën 31.10.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj z. Kadrush Shala është përgjigjur shkresës dhe ka ardhur ne AKK, me datën 07.11.2014 ku është njoftuar nga zyrtaret e AKK-se, për faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin për Konflikt te mundshëm te interesit.

z. Shala, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por na ka njostuar se biznesi ne fjalë me emër D.P.Z “Mega Reklam” nuk zhvillon aktivitet dhe nuk është aktiv qe ne vitin 2012 dhe ka mbetur vetëm si biznes i regjistruar ne ARBK dhe është zotuar se ne asat sa me te shpejt do te veproj sipas rekomandimeve te Agjencisë dhe do te bez ndryshimet e nevojshme dhe do te shmanget nga situata e mundshme e konfliktit te interesit.

Me datën 15.12.2014, z. Kadrush Shala, ka ardhur ne AKK-ë duke na njostuar se është shkarkuar nga pozita si zyrtar i lartë i prokurimit dhe nuk mbanë me pozitën e zyrtarit te lartë.

Po ashtu me datën 16.12.2014 kemi pranuar njoftimin nga KRU “Radoniqi” ku jemi njostuar se z. Kadrush Shala nuk ushtron me funksionin e zyrtarit te larte ne KRU “Radoniqi”.

Vlerësojmë se shkarkimi nga funksioni si zyrtar i lartë ne KRU “Radoniqi”, dhe krijimi i rrethanave te reja kanë bërë qe te shmanget gjendja e mundshme e konfliktit të interesit per ish zyrtarin z. Kadrush Shala, (ish Zyrtarë i lartë i Prokurimit ne KRU “Radoniqi” sh.a.) andaj,

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

